



**GLOBAL
INITIATIVE**

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

INFRASTRUKTURA E INTEGRITETIT



**Korrupsioni dhe zotimet anti-korrupsion
në Ballkanin Perëndimor**

UGLJEŠA UGI ZVEKIĆ DHE SUNČANA ROKSANDIĆ VIDLIČKA

TETOR 2020

INFRASTRUKTURA E INTEGRITETIT

*Korrupsioni dhe zotimet anti-korrupsion
në Ballkanin Perëndimor*

Uglješa Ugi Zvekić &
Sunčana Roksandić Vidlička

Tetor 2020

AUTORËSIA DHE FALËNDERIME

Kjo përmbledhje e përgjithshme dhe raporti i plotë i *Infrastrukturës së Integritetit Korruptsioni dhe zotimet anti-korrupsion në Ballkanin Perëndimor janë materiale të përgatitura nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs), një organizatë anëtare e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar.*

SEE-Obs është një platformë që mbledh së bashku dhe fuqizon organizata të shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi. Observatori kërkon t'i krijojë mundësi shoqërisë civile që të identifikojë, analizojë dhe të krijojë një tablo të prirjeve dhe tendencave kriminale, si dhe ndikimin e tyre mbi trafiket e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe respektimin e ligjit. SEE-Obs mbështet organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për monitorimin e zhvillimeve dhe tendencave të krimin të organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Observatori u krijua në vitin 2018, pas Samitit të Londrës me vendet e Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ky publikim bazohet mbi raporte monitorimi kombëtare të hartuara nga Krisela Hackaj (Shqipëri), Eldan Mujanovic (Bosnjë Hercegovinë), Mentor Vrajolli (Kosovë), Dejan Milovac (Mal i Zi), Slagjana Taseva (Maqedoni e Veriut), dhe Miodrag Milosavljevic (Serbi). Falënderojmë ekspertët për kontributin dhe njohuritë e tyre, si dhe për angazhimin përgjatë gjithë zhvillimit të projektit.

Ky raport u përmbledh dhe u analizua nga Ugljesa (Ugi) Zvekic dhe Suncana Roksandic Vidlicka. Falënderime të veçanta për Walter Kemp dhe Kristina Amerhauser për punën dhe mbështetjen e tyre gjatë hartimit të Përmbledhjes së Përgjithshme dhe raportit.

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.

© 2020 Global Initiative Against Transnational Organized Crime.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në asnjë lloj forme apo mënyre pa miratimin me shkrim nga Iniciativa Globale.

Kopertina: Jocelyn Ramasseul, sipas një koncepti grafik të ideuar nga Ugljesa (Ugi) Zvekic

Ju lutemi, për informacione drejtoheni tek:
The Global Initiative Against Transnational Organised Crime
Avenue de France 23
Geneva, CH-1202
Switzerland


www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

Pëmbledhje e përgjithshme	1
Metodologjia	2
Rezultate dhe analiza	2
Rekomandime	4
Shënime	6



PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME



Korrupsioni është një nga kërcënimet më të mëdha që i kanosen shtetit ligjor, dhe shanseve për një jetë më të mirë të popullit në vendet e Ballkanit perëndimor. Është njëkohësisht shkak dhe pasoja e një kulture dhe mendësie kriminale që vihet re në këtë rajon. Po kështu, ndërlidhja e fortë e korrupsionit me politikën tregon për një nivel korrupsioni të organizuar, madje edhe elemente të kapjes së shtetit në disa vende të rajonit.

Disa nga rastet më tipike të shfaqjes së korrupsionit të organizuar në nivele të larta shtetërore, në gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor (WB6),¹ janë blerja dhe shitja e pronave publike në injorim të plotë të ligjeve nga elitat politike dhe bashkëpunëtorët e tyre në botën e biznesit dhe krimin; procedura korruptive tenderi për projekte infrastrukture (si ndërtimi i rrugëve); pazare të brendshme dhe marrëveshje me njerëzit e tyre besnikë për privatizimin e pronave publike; fshehja e pronësisë së vërtetë; manipulime dhe përvetësime të fondeve publike; mos-deklarimi (apo deklarimi i rremë) i pasurive; pastrim parash (si brenda vendit ashtu dhe në parajsë financiare); si dhe abuzim me postin.

Kërcënimi sistemik që i kanoset rajonit nga korrupsioni duket qartë edhe nga rastet e shpeshta të financimit të partive politike nga individë apo kompani në këmbim të favoreve të ndryshme. Këtu përfshihen fonde nga burime të padeklaruar; blerja e mbështetjes politike me dhurata dhe favore; keqpërdorimi i fondeve publike; si dhe emërimi në administratën civile, apo në kompani shtetërore, të personave të caktuar, si një mënyrë për të krijuar një rrjet patronazhi bazuar në varësinë politike. Në këtë mënyrë, elitat politike, ekonomike dhe kriminale bashkëpunojnë për të ruajtur dhe mbrojtur interesat dhe ndikimin e tyre mbi institucionet dhe pasurinë publike. Këto praktika pune krijojnë një terren pjellor për zyrtarë të korruptuar, dhe i lejon që të veprojnë në një mjedis pandëshkueshmërie.

Pavarësisht nga kjo situatë e rëndë, shoqëritë në rajon duket sikur janë mësuar me korrupsionin e niveleve të larta. Ka një ndjesi të përgjithshme se 'kështu shkojnë gjërat' dhe se sistemi nuk mund të ndryshojë. Kjo impotencë e kushtëzuar mbahet gjallë nga paaftësia e institucioneve që duhet të luftojnë korrupsionin, si pasojë e mungesës së pavarësisë apo kapaciteteve profesionale. Ka patur shumë pak raste të dënimeve për korrupsion të organizuar të niveleve të larta, por nga ana tjetër autoritetet vendosin kufizime drakoniane mbi median, duke përfshirë kërcënime dhe dënime kundër atyre që flasin kundër korrupsionit (veçanërisht kur bëhet flalë për korrupsion në shkallë të gjerë).

Në vendet e Ballkanit perëndimor nuk është zhvilluar shumë punë kërkimore mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar, ndërsa sektori akademik dhe intelektualët kryesisht kanë heshtur në lidhje me këto probleme. Po kështu, në nivel rajonal, ka një angazhim të kufizuar nga ana e shoqërisë civile në lidhje me temën e korrupsionit. Shumë iniciativa, duke përfshirë edhe këtë raport, varen nga mbështetja e jashtme.

Ky raport bazohet mbi analizat e realizuara nga ekspertë që ekzaminuan korrupsionin dhe ndikimin e tij mbi qeverisjen e secilit nga vendet e WB6, dhe analizuan bazën ligjore dhe institucionale anti-korrupsion për secilin vend, si dhe përpjekjet e qeverive për të luftuar korrupsionin. Në veçanti, raporti analizon punën e qeverive të të gjashtë vendeve në lidhje me përbushjen e zotimeve anti-korrupsion, zotime që u morën në kuadër të Procesit të Berlinit, një iniciativë që kërkon të rrisë nivelin e bashkëpunimit rajonal në vendet e Ballkanit perëndimor, si një nga mënyrat për të ndihmuar në procesin e integritetit të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian.² Ky raport kërkon të kontribuojë në mënyrë konstruktive në procesin e zbatimit dhe analizimit të zotimeve anti-korrupsion në kuadër të Procesit të Berlinit, dhe të vërë në pah fushat ku ka nevojë për më shumë punë.

Metodologjia

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC) ndërmori në shtator 2019 iniciativën për të realizuar një analizë të shoqërisë civile mbi zotimet anti-korrupsion të marra nga qeveritë e WB6 pas Takimit të Londrës në vitin 2018. Kjo analizë do të prezantohet në takimin e Procesit të Berlinit në vitin 2020.³

Ekspertë nga vende të ndryshme⁴ punuan së bashku me Observatorin e Shoqërisë Civile Kundër Krimit të Organizuar në Evropën Juglindore të GI-TOC për të analizuar korrupsionin dhe ndikimin e tij mbi qeverisjen e secilit nga vendet e WB6. U zhvilluan intervista me një numër palësh të angazhuara në proces, duke përfshirë përfaqësues nga sistemi i drejtësisë penale, shoqërisë civile, sektorit akademik, dhe medias.

Po kështu, analiza në nivel rajonal e korrupsionit përfshiu edhe shqyrtimin e raporteve të hartuara nga Komisioni Evropian, organi i monitorimit anti-korrupsion të Këshillit të Evropës, që njihet si Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit, Zyra e OKB mbi Drogat dhe Krimin, Komiteti i Ekspertëve mbi Vlerësimin e Masave Anti-Pastrim Parash dhe Financimit të Terrorizmit të Këshillit të Evropës, si dhe Transparency International.

Rezultate dhe analiza

Gjatë përgatitjes së këtij raporti, autorët zbuluan se kishte shumë pak njohuri mbi zotimet anti-korrupsion, si nga ana e publikut të gjerë, ashtu edhe nga institucione qeveritare që duhet të jenë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Gjithashtu, nuk kuptohej qartë se cili nga organet qeveritare kishte për detyrë, apo mbante përgjegjësi, për monitorimin e përbushjes së zotimeve. Kjo bie ndesh me rëndësinë që i kushtuan udhëheqësit e vendeve të WB6 luftës kundër korrupsionit në kuadër të Procesit të Berlinit.

Raporti shqyrton edhe nivelin e punës së vendeve të WB6 në raport me zbatimin e angazhimeve të marra për të përbushur kriteret dhe kërkesat e hyrjes në BE. Pikat kryesore ku është përqendruar analiza – që korrespondojnë me fushat tematike të përmendura në zotime – janë partneriteti publik–privat; prokurimet publike; tatimet; denoncimet e shkeljeve; informacione mbi pronësinë dhe përfituesit realë; iniciativa e transparencës në industrinë e shfrytëzimit të pasurive natyrore; kapacitetet zbatuese;

legjislacioni për konfiskim pasurish; roli i medias; integriteti institucional; edukimi anti-korrupsion; si dhe sistemi ndërkombëtar.

Për të mundësuar analizën, zotimet anti-korrupsion u ndanë në tre kategori kryesore:

- Kritere ekonomike – partneriteti publik–privat; prokurimet publike; tatimet; informacione mbi pronësinë dhe përfituesit, industria e shfrytëzimit të pasurive natyrore
- Kritere politike – mbrojtja e denoncuesve të shkeljeve, kapacitetet zbatuese, media, integriteti institucional, edukimi anti-korrupsion, dhe iniciativat e transparencës
- Përshtatja me legjislacionin e BE – legjislacioni për konfiskim pasurish; sistemi ndërkombëtar

Raporti bën edhe një vlerësim të hollësishëm të punës së secilit vend në raport me korrupsionin, si dhe paraqitet një panoramë rajonale e qëndrimeve të mbajtura nga vendet e WB6 në luftën kundër korrupsionit. Janë shënuar si zhvillime pozitive ashtu edhe mangësi e probleme.

Rezultatet e kësaj analize tregojnë se, në përgjithësi, legjislacioni anti-korrupsion në zonën WB6 respekton parimet e Konventës së OKB kundër Korrupsionit (UNCAC), dhe është në linjë me bazën dhe eksperiencën ligjore të BE (EU acquis).⁵ Sidoqoftë, ka akoma mangësi dhe boshllëqe në bazën ligjore, veçanërisht në lidhje me aksesin dhe transparencën e informacionit publik; pastrimit të parave; financimit të partive politike dhe fushatave elektorale; prokurimet publike; korrupsionin në sektorin privat, konfliktin e interesit dhe pasurimin e paligjshëm; si dhe mbi pronësinë dhe përfituesit realë. Disa ligje aplikohen në mënyrë selektive, ndërsa disa ligje të tjera duket sikur janë miratuar për ta bërë më të lehtë korrupsionin.

Po kështu, rezultatet e studimit tregojnë se shpesh ka një disnivel dhe mospërputhje midis legjislacionit të mirë në letër dhe zbatimit të dobët të ligjit në praktikë. Ajo që konsiderohet si 'optimizëm legjislativ' në rajon duhet të transformohet në realizëm ekzekutiv. Ka rëndësi themelore që të masim dhe të tregojmë ndikimet dhe rezultatet reale të zotimeve anti-korrupsion.

Shtetet do të vlerësohen në bazë të premtimeve që përmbushin, dhe jo thjesht për zotimet e marra.

Të gjitha vendet WB6 kanë miratuar strategji anti-korrupsion, por disa nga këto strategji janë vjetëruar, dhe duhet të adoptohen strategji të reja. Po kështu, edhe mungesa e vullnetit politik ka sabotuar zbatimin e tyre.

Të gjitha vendet WB6 kanë ngritur struktura anti-korrupsion me emërtime të ndryshme, dhe me mandate që ndryshojnë disi nga njëri-tjetri. Shumicës së këtyre organeve i janë dhënë përgjegjësi dhe fuqi shumë të mëdha. Po kështu, ia vlen të përmendet fakti se, si pasojë e procedurave të shpejtuara, shumë prej tyre u krijuan nëpërmjet miratimit të ligjeve që mbulonin fusha specifike dhe që kishin prioritet ndaj ligjeve të përgjithshme (lex specialis). Gjatë 25 viteve të fundit, këto organe kanë kaluar nëpër një sërë transformimesh, por shumë shpesh kanë vuajtur nga ndërhyrjet dhe ndikimi i politikës.

Disa nga vendet WB6 kanë krijuar agjenci ligjzbatuese të specializuara, si dhe prokurori e gjykata speciale, që duhet të merren me raste korrupsioni. Shpesh ka patur konflikte juridiksioni ndërmjet forcave ligjzbatuese e prokurorive speciale dhe atyre të zakonshme, si dhe ndërmjet vetë organeve të specializuara anti-korrupsion. Ndonjëherë, këto organe vihen nën presion politik, si dhe ndërhyrje e presione personale.

Korrupsioni i organizuar politik është shumë i përhapur në vendet e WB6. Megjithatë, ndodh shumë rrallë që politikanë të niveleve të larta të hetohen për akuza korrupsioni. Edhe kur nisen procedime të tilla, shumë rrallë dilet me vendim përfundimtar për konfiskimin e pasurive.

Në raport bëhet edhe një analizë më e gjerë, në nivel rajonal, e ekonomisë politike të korrupsionit. Një nga rezultatet e studimit është se klientelizmi shfaqet në formën e mbështetjes politike nëpërmjet rrjeteve të patronazhit, si për shembull, nëpërmjet kontrollit të ndihmës sociale, punësimit të simpatizantëve politikë në administratën publike, si dhe emërime politike në poste kyçe të administratës shtetërore, duke përfshirë sistemin e drejtësisë penale, dhe kompanitë shtetërore. Besnikëria ndaj pushtetit politik bën të mundur fitimin e kontratave të majme me fonde publike, investime të huaja, privatizime në shkelje flagrante të rregullave, si dhe aplikime selektive të tatimeve. Shkurtimisht, korrupsioni pjell korrupsion.

Rekomandime

Duke marrë në konsideratë këto faktorë, zbatimi i zotimeve anti-korrupsion në kuadër të Procesit të Berlinit ka rëndësi thelbësore. Këtij procesi duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje nga opinioni publik, duhet t'i bëhet më shumë publicitet, dhe duhet t'i kushtohet një angazhim më serioz nga ana e politikës.

Konkretisht, raporti bën thirrje që të shkatërrohen lidhjet korruptive midis politikës, biznesit, dhe krimit në rajon. Ai nënvizon nevojën për funksionimin e një sistemi për parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes, me aktivitet sistematik, të financuar mirë, dhe transparent. Raporti thekson rëndësinë themelore të pavarësisë politike dhe operacionale të këtyre organeve, në mënyrë që të arrihet deri në procedime të rasteve nga drejtësia penale. Po kështu, raporti vëren se është shumë e rëndësishme që të zhvillohet një monitorim i pandërprerë i procesit të përmbushjes së zotimeve anti-korrupsion nga këto vende.

Duke qenë se motivi kryesor i përfshirjes në aktivitete korruptive është përfitimi financiar, duhet bërë më shumë për të diktuar aktivitete financiare të dyshimta, të luftohet pastrimi i parave, si dhe të bllokohen e konfiskohen pasuritë e fituara pa të drejtë.

Është e nevojshme që të sigurohet mbrojtje më e mirë për ata që denoncojnë korrupsionin, si për ata që punojnë në media dhe shoqërinë civile, ashtu dhe për denoncuesit e shkeljeve nga brenda institucioneve.

Lufta kundër korrupsionit është një qëndrim dhe kulturë shoqërore – duhet të shkojë përtej legjislacionit për parandalim dhe të depërtojë në shoqërinë civile. Për të arritur këtu, duhet bërë më shumë për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, si dhe të zhvillohet një kulturë shoqërore integriteti. Shoqëria civile dhe sektori akademik në këtë rajon duhet të mbështeten më shumë, në mënyrë që të jenë në gjendje që të ngrenë zërin kundër korrupsionit, dhe të ndërmarrin studime për të orientuar më mirë ndërhyrjet nga ana e shoqërisë civile. Nga ana tjetër, është e nevojshme që t'i jepet më shumë mbështetje institucioneve të pavarura dhe kompetente.

Po kështu, e gjithë shoqëria duhet të përfshihet në promovimin e një kulture ligjshmërie.

Raporti tregon se sektori privat në vendet e WB6 angazhohet vetëm në mënyrë minimale në parandalimin apo luftën kundër korrupsionit – pavarësisht nga fakti se korrupsioni konsiderohet si një pengesat kryesore për të bërë biznes në rajon. Në vendet e WB6, sektori privat rrallë jep fonde për aktivitete anti-korrupsion. Ky mund të jetë

një tregues i pranimit të heshtur të korrupsionit, si një mënyrë për të bërë biznes – por pasqyron edhe mungesën e kulturës së përgjegjësisë sociale të kompanive. Ka goxha hapësirë për angazhimin e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit, si në ambientin e biznesit, ashtu edhe në marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe qeverinë. Në fakt, angazhimi i sektorit të biznesit ka rëndësi themelore për arritjen e suksesit të çdo strategjie anti-korrupsion.

Raporti arriti në përfundimin se media është në pozicion të mirë për të kryer rolin e një kundërpjeshe, duke ekspozuar korrupsionin në vendet e Ballkanit perëndimor. Gazetarë investigativë kanë krijuar rrjete ndërkombëtare dhe rajonale, dhe po bëjnë punë të shkëlqyer. Sidoqoftë, mediat në vendet e WB6 funksionojnë në kushte të vështira, dhe vuajnë nga mungesa e pavarësisë dhe lirisë. Duhet urgjentisht që të promovohet dhe mbrohet liria e medias, dhe të sigurohet transparencë dhe akses i lirë në informacione publike. Po kështu, ka nevojë të madhe për iniciativë të mediave investigative, dhe ato duhen promovuar e mbështetur.

Ka shumë pak organizata jo-qeveritare në rajon që merren me krimin e organizuar dhe korrupsionin, por edhe ato marrin shumë pak mbështetje apo bashkëpunim nga ana e qeverive. Ashtu si media, edhe OJQ-të lokale mund të luajnë një rol të dorës së parë në promovimin e rezistencës komunitare ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Një bashkëpunim më i mirë në nivel rajonal ndërmjet OJQ-ve që merren me korrupsionin mund të ndihmojë në reduktimin e korrupsionit dhe forcimin e rezistencës.

Në një plan më të gjerë, bashkëpunimi rajonal është një element kyç për hartimin e planeve dhe strategjive gjithëpërfshirëse, me ndikim real në terren, kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vendet e WB6 duhet t'i kushtojnë shumë më tepër vëmendje shkëmbimit të eksperiencës, praktikave të mira të punës, dhe njohurive operative. Krijimi i një rrjeti, dhe kontaktet e rregullta midis palëve të interesuara në rajon kanë rëndësi thelbësore. Përpjekjet në këtë drejtim, të mbështetura edhe nga komuniteti i donatorëve, duhet të promovohen më tej. Për shembull, mund të koordinohet shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimi rajonal, duke kaluar deri në veprime të përbashkëta në fusha të caktuara. Ky proces mund të ndihmojë edhe në forcimin e besimit midis palëve në rajon.

Raporti nënvizon faktin se nuk ka një sistem vlerësimi për ndikimin e politikave në terren, dhe mundohet ta plotësojë këtë boshllëk. Kjo është një çështje me rëndësi thelbësore, pasi monitorimi i përmbushjes së zotimeve anti-korrupsion mundëson analizën brenda një kornize transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke përcaktuar edhe standardet bazë për matjen e ecurisë së punës. Për të arritur këtë duhet që të identifikohen tregues specifikë për secilin zotim, në mënyrë që të matet ndikimi në terren, dhe të sigurohemi nëse ka patur ndryshime reale apo jo. Një monitorim i tillë sistemik nuk mund të jetë një veprimtari sporadike, që mbaron brenda një cikli: kjo veprimtari duhet të jetë pjesë e një procesi gjithëpërfshirës, transparent, dhe të vazhdueshëm. Ky proces duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara, dhe në veçanti duhet të mundësojë një marrëdhënie partneriteti ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.

Në përfundim, duke përmbushur zotimet anti-korrupsion të Procesit të Berlinit, të gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor mund të parandalojnë dhe denoncojnë korrupsionin, të dënojnë të korruptuarit, dhe të mbështetin ata që kanë vuajtur si pasojë e korrupsionit. Kjo do të ndihmojë në forcimin e integritetit, në mbështetjen e një sistemi të pavarur dhe profesional të drejtësisë penale, në forcimin e rezistencës ndaj korrupsionit, dhe në zhvillimin e kulturës së ligjshmërisë. Mesazhi duhet të jetë që ligji është i barabartë për të gjithë.

SHËNIME

- 1 WB6 i referohet gjashtë vendeve të Ballkanit perëndimor: Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë, dhe Kosovës. Referencat ndaj Kosovës bëhen pa paragjykuar pozicionin në lidhje me statusin, dhe respektojnë parimet e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244/1999, si dhe Opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklarin e pavarësisë nga ana e Kosovës.
- 2 Për më shumë, shiko Qendrën e Informimit dhe Burimeve të Procesit të Berlinit, <https://berlinprocess.info/about/>.
- 3 Takimi i Berlinit ishte planifikuar të mbahej në muajin korrik 2020, dhe do të organizohej në bashkëpunim midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, por u shty si pasojë e COVID-19. Shpresohet që ky takim të zhvillohet në nëntor 2020.
- 4 Krisela Hackaj (Shqipëri), Eldan Mujanovic (Bosnjë Hercegovinë), Mentor Vrajolli (Kosovë), Dejan Milovac (Mal i Zi), Slagjana Taseva (Maqedoni e Veriut), dhe Miodrag Milosavljevic (Serbi).
- 5 Termi 'EU acquis' i referohet legjislacionit të akumuluar, akteve ligjore dhe vendimeve gjyqësore që përbëjnë bazën ligjore të Bashkimit Evropian.



GLOBAL INITIATIVE

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

MBI INICIATIVËN GLOBALE

Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 500 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përfaqësive inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimin të organizuar.

www.globalinitiative.net